



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më 01/11/2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: objekt “Shërbim sinjalistike horizontale për rruget e Bashkis Fier” (Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Sinjalistikë rrugore” 34992200-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 10 000 000 (dhjete milion) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrjes së Shërbimeve Publike Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2020, 2021**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **4 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e Thjeshtuar, përkatësisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislativ dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në perputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Në këte rast, vlera e kërkuar është jo më pak se **2 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 3 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **2 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vertetur nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

1. Inxhinier ndërtimi/Infrastruktura 1 (një).

Inxhinieri i mesipër duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën **Shtator 2022**. Për inxhinierin duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*).

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës personel të kualifikuar/certifikuar si më poshtë:

- 1 (një) punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili të jetë i certifikuar **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij ose me kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:

➤ Manovrator 2 (dy)

Për specialistet e sipërcituar duhet të paraqiten dëshmi/certifikate ose cdo dokument tjetër që verteton diplomimin apo kualifikimin e tyre, si dhe kontratë individuale të punës e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të kontratës.

Shënim: Për pikat **a)**, **b)** dhe **c)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në shkronjat a), b) dhe c) të pikës **2.3.2**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.3 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **5 (pesë) punonjës**, për **muajin Shtator 2022**.

Shënim: Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetimi të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Shtator 2022**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Shtator 2022**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor

(njesia e prokurimit) ka kerkuar paraqitjen e listepageses se muajit **Shtator 2022** per arsye se eshte muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates. Bazuar ne ligjin nr.9136 date 11.09.2003 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe te pagesës*), operatoret ekonomike kane afat te shlyejne detyrimet per sigurimet shoqerore e shendetesore brenda dates 20 te muajit pasardhes.

2.3.4 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndertim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:**
 - NS – 6/A (Sinjalistika rrugore jondricuese)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar. Me anë të letij kriteri kerkohet që operatoret ekonomike të dëshmojnë se disponojnë licensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve ,objekt I kontrates të leshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësive ISO 9001-2015 ose ekuivalente e saj për objektin që prokurohet (*e cila duhet të jetë e perkthyer në shqip dhe e noterizuar*) e leshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 ose ekuivalente e saj për objektin që prokurohet (*e cila duhet të jetë e perkthyer në shqip dhe e noterizuar*) e leshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që autoriteti kontraktor të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikatën e menaxhimit të cilësive që parashikohet nga legjislacioni në fuqi për objektin e prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Certifikata për menaxhimin e cilësive ISO 9001 është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësive të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK sepse garanton se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për produktet e ofruara dhe zbatimin e kontratës sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

Certifikata për menaxhimin e mjedisit ISO 14001 është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të mjedisit të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK sepse garanton se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të mjedisit për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës sipas të gjitha standarteve të mjedisit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje dhe/ose skede teknike , që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike për zerat 3 dhe 4 të preventivit, të cilat duhet të jenë në përputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor. *[Nese materiali/et të cilat do të paraqiten për të përmbushur kriterin e mesipër janë në gjuhë të huaj, ato duhet të perkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kerkuara si dhe të noterizuara].*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku citohet: *”Autoriteti/enti kontraktor përveç kërkesave të parashikuara në këto nene mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta në varesi të objektit që përkurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Paraqitja e katalogjeve është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së mallrave që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion:

a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.9):

Nr.	Mjetet	Sasia (copë)	Statusi
1.	Mjet transporti jo me pak se 1,5ton(me vinc)	1 (një)	Në pronësi ose me qera
2.	Semafor per menaxhim trafiku	1 (një)	Në pronësi ose me qera
3.	Kone plastike	25(njezet e pese)	Në pronësi ose me qera
4.	Pajisje per matje retroreflektivitetit te bojës se vijeimit rrugor	1 (një)	Në pronësi ose me qera
5.	Makineri vijejimi per bojë bikomponente sprajt	1 (një)	Në pronësi ose me qera
6.	Automjet vijejimi (APF) me boje termoplastike(sprajt)	1 (një)	Në pronësi ose me qera

b) Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronesi ose me qera), te nevojshme per ekzekutimin e kontrates si me poshte (*sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojcës nr.9*):

- Kokore, minimum 5 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 (katër) copë

Shënim: Për pikën **2.3.7 (a dhe b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën **2.3.7 (a dhe b)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontraten perkatese noteriale të qerases e vlefshme .

- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.
- e) Makinat e transportit të shoqerohen gjithashtu edhe me **Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme)**, leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kërkesat për disponimin ose mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kërkuara në këto kërkesa për kualifikim, bazohet edhe në nevojën për mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si për mjetet që do të angazhohen në zbatimin e kontratës, ashtu edhe për kapacitet teknike që lidhen me gadishmerinë për plotësimin e tyre në rrethana të caktuara, duke pasur si synim zbatimin e në kohë dhe në cilësi të kontratës objekt prokurimi.

Gjithashtu kërkesat për makineritë/mjetet që nevojiten argumentohet në bazë të zerave të preventivit:

Nr.	Mjetet	Sasia (copë)	Statusi	Shenime
1.	Makineri vijezi për bojë bikomponente sprajt	1 (një)	Në pronësi ose me qera	Për zërin e preventivit nr.1,2 dhe 3
2.	Automjet vijezi (APF) me bojë termoplastike(sprajt)	1 (një)	Në pronësi ose me qera	Për zërin e preventivit nr.4
3.	Pajisje për matje retroreflektivitetit të bojës së vijezi rrugor	1 (një)	Në pronësi ose me qera	Për zërin e preventivit nr.1-4

Mjet transporti jo me pak se 1,5ton(me vinc) eshte kerkuar per transportin e materialeve dhe mjeteve qe do te perdoren per pune nga nje segment rrugore ne tjetrin sipas nevojave te AK.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur DST ne SPE.

Kriteret e vecanta te kualifikimit qe lidhen me kapacitetin teknik jane hartuar nga specialisti i fushes pjese e njesise se prokurimit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Njësia e prokurimit: